



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 17.03.2026

Nr 466/2 prot.

Lënda: Njoftim për mbledhjen e këshillit bashkiak Pukë.

Antarëve të Këshillit të Bashkisë Pukë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesisë së këshillit nr. 2 datë 17.03.2026, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë do të zhvillohet më datën **25.03.2026**, ora **13³⁰** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.02.2026
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar** 2026.
3. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shkurt** 2026.
4. Projekt-vendim : "Për miratimin e anekseve të monitorimit të Buxhetit, 12 mujori i vitit 2025"
5. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë " Z. Gjon Berisha.
6. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë " Z. Kadri Morina.
7. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë " Imam Adem Ademi.
8. Projekt-vendim : "Për miratimin e krijimit të këshillit vendor për sigurinë publike në Bashkinë Pukë"
9. Për lirim nga detyra e sekretarit të Këshillit Bashkiak, i cili përfundon marrëdhëniet e punës me datë 30 Prill 2026, pasi del në pension.
10. Për zgjedhjen e sekretarit të ri të këshillit bashkiak, i cili fillon marrëdhëniet e punës me datë 01 Maj 2026.
11. Të tjera.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përherëshme të këshillit zhvillohen më datë 24.03.2026, nga ora 14-³⁰ deri në orën 16⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Duke ju falenderuar për mirekuptimin dhe bashkëpunim, ju lutem konfirmoni pjesëmarrjen në mbledhje!

SEKRETARI
Hazbi TERBUNI